

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8309  
E premte, 29 maj 2026  
Çmimi 0.50 €

## Stradneri: Vizita e kongresistëve, hap për riafirmimin e angazhimit të ShBA-së për paqe në rajon

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# NIS FUSHATA PËR ZGJEDHJET E 7 QERSHORIT, BËHET THIRRJE PËR GARË DEMOKRATIKE MES PARTIVE POLITIKE

FAQE 4-5




Ka nisur zyrtarisht këtë të enjte fushata zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë e cila do të zgjasë deri më 7 qershor, në orën 07:00, kur edhe hapen qendrat e votimit. Sipas të dhënave të publikuara nga

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në këtë proces zgjedhor janë certifikuar 21 subjekte politike, ndërsa në garë për ulëse në Kuvend janë gjithsej 902 kandidatë për deputetë. Me fillimin zyrtar të fushatës zgjedhore, Demokracia në

Veprim (DnV) u ka bërë thirrje partive politike dhe kandidatëve për deputetë që t'i respektojnë standardet dhe rregullat në fuqi për një garë demokratike, fer dhe të orientuar në përmbajtje programore

## AKTUALE



### SHOIPËRIA REFUZON KËRKESËN E RUSISË PËR LARGIMIN E DIPLOMATËVE NGA KIEVI

F. 2

### INSPEKTORATI QENDROR I PUNËS PARAQET SISTEMIN ELEKTRONIK PËR MENAXHIMIN E RASTEVE

F. 6

### KURTI: XHANDARMËRIA DO TË KETË MANDAT SIGURIMIN E VIJËS KUFITARE TOKËSORE

F. 6

## EKONOMI



### AUTORITETET E KOSOVËS MARRIN NË KONTROLL INFRASTRUKTURËN HEKURUDHORE NË VERI

F. 6

### RRITET KOSTOJA E NDËRTIMIT

F. 6

## SPORT



### FODA: MIQËSORJA NDAJ ÇEKISË DHE AJO NDAJ ANDORRËS NA SHËRBEJNË PËR LIGËN E KOMBEVE

F. 11



### HAMZA PARAQET PESË ZOTIMET KRYESORE TË PROGRAMIT TË PDK-SË: MË 7 QERSHOR VOTOJENI NUMRIN 125

F. 5

### KOMUNAT PO BALLAFAQOHEN ME NDËRHYRJE TË KOMPETENCAVE NË ASPEKTIN JURIDIK DHE FINANCIAR

F. 8



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mok: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## SHQIPËRIA REFUZON KËRKESËN E RUSISË PËR LARGIMIN E DIPLOMATËVE NGA KIEVI

TIRANË, 28 MAJ - Shqipëria nuk do t'i bindet kërkesës së Rusisë, pasi ajo kërkoi largimin e diplomatëve dhe qytetarëve të huaj nga kryeqyteti ukrainas, Kiev. Kërkesë të tillë Rusia ka bërë edhe ndaj Shteteve të Bashkuara më 25 maj. Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ferit Hoxha, e vlerësoi këtë njoftim të Rusisë si të "papranueshëm" dhe tha se Shqipëria nuk do të tërhiqet. "Shqipëria e konsideron njoftimin e Rusisë, ku u bënë thirrje personelit diplomatik dhe qytetarëve të huaj të largohen nga Kiev përpara sulmeve të planifikuara, si krejtësisht të papranueshëm.

Kërcënimi i ambasadave nuk është diplomaci, është intimidim. Ai përfaqëson një tjetër shkëlqje të së drejtës ndërkombëtare dhe të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike. Shqipëria nuk do të tërhiqet", shkroi Hoxha në X. Sipas tij, Shqipëria do të vazhdojë ta mbështesë Ukrainë dhe ky qëndrim i është përcjellë të enjten ambasadorit të Rusisë në Tiranë, Alexey Zaitsev. Kryediplomati Hoxha tha se përgjigja në luftën mes Rusisë dhe Ukrainës nuk mund të jetë më shumë luftë, "më shumë krime apo sulme pa dallim kundër civilëve dhe



infrastrukturës civile". E vetmja rrugë përpara, tha ai, është t'i jepet fund luftës përmes angazhimit në negociata të vërteta dhe me mirëbesim për paqe. Më 24 maj Rusia lëshoi qindra raketa dhe dronë ndaj kryeqytetit ukrainas, Kiev. Në mesin e caqeve të goditura ishte edhe rezidenca e ambasadorit shqiptar në Ukrainë, Ernal Filo. Gjatë këtij sulmi masiv u vranë të paktën katër persona. Shqipëria e hapi për herë të parë Ambasadën e saj në Kiev në tetor të vitit 2024, dy vjet pasi Rusia nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës.

## SHBA-ja KONFIRMON SULMET E REJA "MBROJTËSE" NË IRAN

WASHINGTON, 28 MAJ - Ushtria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës kreu sulme të reja ndaj një objekti ushtarak iranian dhe rrëzoi disa dronë pranë Ngushticës së Hormuzit, thanë zyrtarë amerikanë më 27 maj, në shkëmbimin më të fundit të veprimeve ushtarake, pavarësisht prej shenjave për përparim diplomatik drejt një marrëveshjeje për t'i dhënë fund konfliktit. Zyrtarë të lartë amerikanë, duke folur në kushte anonimiteti, u thanë gazetarëve se objekti i goditur konsiderohej si një kërcënim i mundshëm për forcat amerikane dhe për anijet tregtare që operojnë pranë kësaj rruge strategjike detare, përmes së cilës kalonte rreth një e pesta e transportit botëror të naftës para shpërthimit të luftës në fund të

shkurtit. Një zyrtar tha se forcat amerikane rrëzuan gjithashtu katër dronë kamikazë iranianë dhe goditën një qendër kontrolli në tokë në qytetin port jugor Bandar Abas, nga ku po përgatitej lëshimi i një droni të pestë. Bandar Abas ndodhet në bregdetin jugor të Iranit, përgjatë Gjirit Persik, pranë Ngushticës së Hormuzit - një nga pikat më të rëndësishme strategjike për transportin detar në botë. Komanda Qendrore Amerikane (CENTCOM) e konfirmoi më vonë sulmin përmes një deklarate, duke thënë se dronët kamikazë iranianë "paraqisnin kërcënim" pranë Ngushticës së Hormuzit dhe se "veprimet ishin të matura, thjesht mbrojtëse dhe të synuara për të ruajtur

armëpushimin". Zhvillimet e fundit ushtarake vijnë në një kohë kur Uashingtoni dhe Teherani po vazhdojnë bisedimet për stabilizimin e situatës pas muajsh tensionesh të larta në rajon. Më herët gjatë kësaj jave, ShBA-ja tha se kishte kryer ato që i quajti "sulme vetëmbrojtëse" ndaj anijeve që dyshohej se po vendosnin mina detare. Irani i dënoi ato operacione, duke i cilësuar shkëlqje të një armëpushimi që, sipas tij, mbetet i brishtë. Përplasjet e fundit tregojnë se rajoni i Gjirit vazhdon të mbetet i paqëndrueshëm pavarësisht prej deklaratave të presidentit amerikan Donald Trump që lënë të kuptohet se ka përparim në përpjekjet diplomatike për



arritjen e një marrëveshjeje. Shtetet e Bashkuara dhe Irani kanë shkëmbyer propozime përmes ndërmjetësimit të Pakistanit.

### Reagimi i Iranit

Korpusi i Gardës Revolucionare Islamike të Iranit (IRGC) tha më 28 maj se kishte shënjestruar një bazë ajrore amerikane, pas atij që e përshkroi si një sulm amerikan në orët e para të mëngjesit pranë aeroportit të

Bandar Abasit në jug të Iranit, sipas agjencisë së lajmeve Tasnim, e lidhur me IRGC-në. Në një deklaratë të publikuar nga Tasnim, IRGC-ja tha se kishte goditur bazën amerikane me "predha ajrore" në orën 04:50 të mëngjesit. Gardat Revolucionare nuk e specifikuan vendndodhjen e bazës, megjithëse ushtria e Kuvajtit tha se mbrojtja e saj ajrore po u kundërpërgjigjej sulmeve "armiçësore" me raketa dhe dronë më 28 maj. Kuvajti, i cili strehon një bazë ajrore amerikane, nuk sqaroi nëse kërcënimet ishin iraniane. IRGC-ja paralajmëroi se çdo sulm i mëtejshëm amerikan do të përballej me një përgjigje "më vendimtare", duke shtuar se Uashingtoni mban përgjegjësi për pasojat.

## Inteligjenca britanike: Rreth 500 000 ushtarë rusë janë vranë në Ukrainë

LONDËR, 28 MAJ - Rreth 500 000 ushtarë rusë besohet se janë vranë gjatë pushtimit në shkallë të plotë të Ukrainës nga Moska, që nisi më 2022, tha një zyrtarë e lartë e inteligjencës britanike, në kohën kur luftimet kanë arritur pothuajse në ngërç. Shifra u bë publike më 27 maj, gjatë një fjalimi të Anne Keast-Butler, drejtoreshës së GCHQ-së, agjencisë kryesore britanike për inteligjencën dhe sigurinë kibernetike. Ajo përputhet me vlerësime të tjera të bëra muajt e fundit nga qeveri perëndimore dhe organizata të pavarura mediatike. Keast-Butler përsëriti paralajmërimet e tjera të qeverisë britanike se Rusia po



"shënjestron paseshtur infrastrukturën kritike, proceset demokratike, zinxhirët e furnizimit dhe besimin publik" në Britani dhe në mbarë Evropën. GCHQ është njësisë kryesore britanike për inteligjencë, e ngjashme me Agjencinë Kombëtare të Sigurisë në Shtetet e Bashkuara.

Keast-Butler tha se GCHQ po përqendrohet në mbrojtjen e kablove dhe tubacioneve nënujore që lidhin Britaninë me pjesën tjetër të botës si dhe në luftimin e "sabotazheve dhe përpjekjeve për atentate". Ajo shtoi se autoritetet po përpiqen t'i pengojnë përpjekjet ruse për të kontrabanduar teknologji perëndimore, duke anashkaluar sanksionet e vendosura nga Perëndimi si përgjigje ndaj pushtimit të Ukrainës në shkurt të vitit 2022. "Ndërsa mbetemi të palëkundur në mbështetjen tonë për Ukrainën, [presidenti rus, Vladimir] Putini po zbrapsset në fushëbetë, me informacione të reja të

inteligjencës që tregojnë se pothuajse gjysmë milioni ushtarë rusë janë vranë që nga fillimi i konfliktit", tha ajo. Kjo shifër është e ngjashme me vlerësime të tjera publike, të cilat kanë nxjerrë në pah përmasat e dëmeve që ushtria ruse ka pësuar në Ukrainë që nga nisja e pushtimit. Në raportin vjetor të publikuar muajin e kaluar, agjencia kryesore e inteligjencës ushtarake e Holandës vlerësoi se Rusia ka pësuar 1.2 milion humbje, përfshirë më shumë se 500 000 të vranë. Një bilanc i përbashkët i medieve ruse në ekzil, Mediazona dhe Meduza, i bazuar në dokumentet e

çështjeve të trashëgimisë, vlerësoi se numri i ushtarëve rusë të vranë që nga viti 2022 është të paktën 352 000. Deri në fund të vitit të kaluar Rusia po përparonte ende ngadalë, duke përdorur taktika të infiltrimit në shkallë të vogël për ta thyer mbrojtjen ukrainase, por me humbje jashtëzakonisht të mëdha. Megjithatë, kohët e fundit, forcat ukrainase, duke u mbështetur shumë në inovacionet me dronë dhe në taktika të reja të përdorimit të tyre, kanë arritur pothuajse ta ndalin përparimin rus. Në disa zona Ukraina ka arritur edhe të rimarrë pjesë të vogla territori.

# STRADNER: VIZITA E KONGRESISTËVE, HAP PËR RIAFIRMIMIN E ANGAZHIMIT TË SHBA-SË PËR PAQE NË RAJON



PRISHTINË, 28 MAJ - Vizita e dy kongresistëve amerikanë në Ballkanin Perëndimor është hap i rëndësishëm për riafirmimin e Shteteve të Bashkuara për paqe dhe stabilitet në rajon “në një kohë kur Serbia dhe Rusia vazhdojnë përpjekjet për destabilizim”.

Kështu e vlerëson Ivana Stradner nga Fondacioni për Mbrojtjen e Demokracisë në Uashington vizitën e kongresistit republikan Keith Self dhe atij demokrat Suhas Subramanyam, në Bosnjë-Hercegovinë, Serbi, përkatësisht në Luginë të Preshevës, dhe Kosovën javën që shkoi. “Kosova dhe Bosnjë-Hercegovina mbeten veçmas të cenueshme nga ndikimi dashakeq dhe presioni politik nga Beogradi dhe Moska”, thotë Stradner për Radion Evropa e Lirë.

Ballkani Perëndimor mbetet një rajon me tensione të shtuara politike dhe ndikime të jashtme, u tha në një raport të publikuar më herët gjatë vitit nga shërbimet amerikane të inteligjencës, të cilat veçanërisht rrolin e Rusisë në destabilizimin e rajonit.

Në raportin e shërbimeve të inteligjencës amerikane u tha se Ballkani Perëndimor mbetet një zonë me tensione të shtuara

politike dhe ndikime të jashtme, duke veçuar rrolin e Rusisë në destabilizimin e rajonit. Sipas raportit, Rusia “nxit paqëndrueshmëri midis Serbisë, të cilën e favorizon, dhe Kosovës” por, gjithashtu, “mbështet ndarjen entitetit serb, Republika Sërpska nga Bosnjë-Hercegovina”.

Gjatë vizitës në Bosnjë dhe Kosovës, sipas autoriteteve vendëse, kongresistët amerikanë biseduan me udhëheqësit për çështje të sigurisë, situatën në rajon dhe raportet dypalëshe. Në Kosovë, sipas krerëve shtetërorë u bisedua edhe për anëtarësimin e vendit në NATO. Sipas Stradnerit, kongresisti Self, që është kryetar i nënkomisionit për Evropë në Komisionin për Punë të Jashtme në Dhomën e Përfaqësuesve, e kupton që Ballkani nuk mund të trajtohet “si çështje dytësore”, përdërisa “Rusia dhe Serbia shfrytëzojnë çdo vijë ndarëse rajonale për të dobësuar Perëndimin”.

“Çdo reduktim të pranisë amerikane do të krijonte një vakum të rrezikshëm që Moska dhe Beogradi shpejt do ta shfrytëzonin”, thotë Stradner.

Ajo shton se stabiliteti në rajon është i lidhur direkt me sigurinë e gjerë evropiane. “Vizita dërgon një sinjal të rëndësishëm se

angazhimi i ShBA-së dhe parandalimi mbeten thelbësor për të mos lejuar një cikël të ri të destabilizimit rajonal”.

Duke folur për Kosovën, ajo thotë se ka “shqetësime në rritje lidhur me të ardhmen e KFOR-it në Kosovë”, përfshirë edhe “frikën e një tërheqjeje të mundshme të ShBA-së”. “Do të ishte një gabim tragjik nga i cili drejtpërdrejt do të përfitonin Rusia dhe Serbia, përdërisa do të minohej siguria rajonale dhe stabiliteti”, vlerëson Stradner.

Së voni ka pasur raportime dhe diskutime për mundësinë që Uashingtoni ta rishqyrtojë praninë e trupave të tij në misionet e NATO-s, përfshirë në KFOR. Megjithatë, Pentagoni i ka thënë më herët Radios Evropa e Lirë se nuk ka ndonjë njoftim për ndryshim të vendosjes së forcave amerikane.

Në prill kongresisti Self, së bashku me kolegët e tij Ritchie Torres dhe Mike Lawler, iniciuan dy rezoluta për Kosovën. E para synon ta shtyjë përpara rrugën e Kosovës drejt Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO).

Ndërkaq, rezoluta tjetër i bën thirrje ShBA-së që ta vazhdojë pjesëmarrjen në KFOR.

Gjatë takimeve në Kosovë, ushtruesja e detyrës së

presidentit, Albulena Haxhiu, dhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti, falënderuan kongresistët për mbështetjen e aspiratës së Kosovës për anëtarësim në aleancën ushtarake perëndimore dhe për vazhdimin e pranisë ushtarake amerikane.

Kosova synon të anëtarësohet në aleancën ushtarake perëndimore, por ende nuk ka bërë kërkesë zyrtare për anëtarësim, teksa mosnjohja nga katër shtete të NATO-s (Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja) vlerësohet pengesë drejt anëtarësimit në aleancë.

Stradner nga Fondacioni për Mbrojtjen e Demokracisë në Uashington, duke folur për situatën në rajon, e fajëson Serbinë për krijim të paqëndrueshmërisë në Ballkanin Perëndimor. Sipas saj, qeveria në Serbi po përballet me pakënaqësi në rritje brenda vendit dhe kundërshti ndaj “sundimit në rritje autokratik të [presidentit serb, Aleksandar] Vuçiq. Modeli i tij qeverisës antidemokratik ka kontribuar shumë në jostabilitetin në mbarë Ballkanin Perëndimor dhe Self e sheh qartë këtë lojë të Vuçiqit”.

Sa i përket Bosnjës, Stradner thotë se situata është

shqetësuese pasi korniza e Dejtonit, sipas saj, po përballet me presion në rritje dhe përpjekje destabilizuese nga Millorad Dodik. “Është e rëndësishme që Self të dërgojë mesazh të qartë që ShBA-ja nuk do të tolerojë kërcënime apo përpjekje që do të minonin sovranitetin e Bosnjës”, thotë ajo. Në vitet e fundit, në entitetin e Republikës Sërpska në Bosnjë janë miratuar një sërë ligjesh jokushtetuese, teksa ish-udhëheqësi i entitetit serb, Millorad Dodik, njihet prej vitësh për retorikën e tij secesioniste.

Ndonëse kongresistët amerikanë nuk vizituan Malin e Zi, Stradner thotë se ky shtet po vazhdon të jetë nën presion në një moment të rëndësishëm të rrugës së tij drejt anëtarësimit në BE. “Presidenti Vuçiq vazhdon të ushtrojë ndikim që synon ngadalësimin e trajektoreve euroatlantike të Malit të Zi dhe të mbajë të ndarë politikisht rajonin dhe të paqëndrueshëm”, thotë Stradner për Radion Evropa e Lirë.

Malin e Zi është shteti që ka bërë përparim më të madh drejt anëtarësimit në BE nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Podgorica pritet që të jetë anëtarja më e re e bllokut evropian në vitet në vijim.



# NIS FUSHATA PËR ZGJEDHJET E 7 QERSHORIT, BËHET THIRRJE PËR GARË DEMOKRATIKE MES PARTIVE POLITIKE

Ka nisur zyrtarisht këtë të enjte fushata zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë e cila do të zgjasë deri më 7 qershor, në orën 07:00, kur edhe hapen qendrat e votimit. Sipas të dhënave të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në këtë proces zgjedhor janë certifikuar 21 subjekte politike, ndërsa në garë për ulëse në Kuvend janë gjithsej 902 kandidatë për deputetë. Me fillimin zyrtar të fushatës zgjedhore, Demokracia në Veprim (DnV) u ka bërë thirrje partive politike dhe kandidatëve për deputetë që t'i respektojnë standardet dhe rregullat në fuqi për një garë demokratike, fer dhe të orientuar në përmbajtje programore

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 28 MAJ - Partitë politike kanë hapur të enjten fushatën elektorale për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit. Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës kanë hapur fushatën në Ferizaj, Lidhja Demokratike e Kosovës në Prishtinë dhe Aleanca në Gjakovë. Secili kandidat për kryeministër ka paraqitur

programet qeverisëse për katër vitet e ardhshme. LV-ja në zgjedhjet e 7 qershorit garon me sloganin "Krejt për shtet, shtet për krejt. Qitja pikën". PDK-ja me sloganin "Stop krizës. Ndrysho Kosovën". LDK-ja me sloganin "Bashkohu!", ndërkaq Aleanca me sloganin "Siguri, energji zhvillim". Fushata do të zgjasë deri më 7 qershor, në orën 07:00, kur edhe hapen qendrat e votimit. Sipas të dhënave të publikuara nga Komisioni

Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në këtë proces zgjedhor janë certifikuar 21 subjekte politike, ndërsa në garë për ulëse në Kuvend janë gjithsej 902 kandidatë për deputetë. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka bërë me dije se kohëzgjatja e fushatës është e përcaktuar me ligj dhe do të zhvillohet për 10 ditë e shtatë orë. Ai ka rikujtuar se, bazuar në ndryshimet ligjore të miratuara në vitin 2023, fushata përmbyllet në momentin kur hapen qendrat

e votimit në ditën e zgjedhjeve. "Për 10 ditë e 7 orë, 21 subjektet politike me 902 kandidatët për deputetë do të mund të zhvillojnë aktivitetet e tyre në kuadër të fushatës zgjedhore. Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i miratuar në vitin 2023, fushata zgjedhore përfundon me hapjen e qendrave të votimit në ditën e zgjedhjeve. Pra, ashtu si në zgjedhjet parlamentare dhe lokale të vitit 2025, dita e shtunë nuk do të jetë heshtje zgjedhore", ka deklaruar Elezi. Elezi ka sqaruar se trajtimi i ankesave për shkelje eventuale gjatë fushatës nuk është kompetencë e KQZ-së, por e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). Megjithatë, sipas tij, KQZ do të ketë rol monitorues gjatë gjithë periudhës së fushatës, përmes angazhimit të monitoruesve në të gjitha komunat e vendit, të cilët do t'i përcjellin aktivitetet e

subjekteve politike dhe do të hartojnë raporte lidhur me organizimin e tubimeve, reklamave dhe materialeve promovuese. "Sipas ligjit, KQZ nuk i trajton ankesat për shkelje gjatë fushatës zgjedhore, pasi kjo është detyrë e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Megjithatë, KQZ ka rol në monitorimin e organizimit të takimeve, fushatave reklamuese dhe materialeve të tjera promovuese. Përmes Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, do të angazhohen monitorues në të gjitha komunat e Kosovës, të cilët do të përgatisin raporte për aktivitetet e subjekteve politike. Këto raporte do të shfrytëzohen si burim informacioni për evidentimin dhe krahasimin me të dhënat e deklaruara në raportin financiar të fushatës të cilin e dorëzojnë subjektet politike",

# HAMZA PARAQET PESË ZOTIMET KRYESORE TË PROGRAMIT TË PDK-SË: MË 7 QERSHOR VOTOJENI NUMRIN 125

PRISHTINË, 28 MAJ - Kryetari dhe kandidati për kryeministër i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, u ka bërë thirrje qytetarëve që më 7 qershor ta votojnë numrin 125 për t'i thënë stop krizës dhe për ta ndryshuar Kosovën. Hamza në një konferencë për medie të enjten paraqiti pesë zotimet kryesore të programit të PDK-së: çmime e tatime më të ulëta, paga e pensione më të larta dhe mbështetje për bizneset; investime në energji, infrastrukturë dhe teknologji të

reja; shëndetësi cilësore, me shërbime më të shpejta dhe të qasshme për çdo qytetar; arsim konkurrues, aftësi për të ardhmen dhe mundësi për të rinjtë; si dhe drejtësi e pavarur, e paanshme dhe efikase. "Programi i Partisë Demokratike të Kosovës është një program konkret, i matshëm dhe i realizueshëm, i hartuar nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë. Ai trajton me seriozitet të gjitha çështjet me rëndësi jetike për shtetin dhe qytetarët, me një qëllim të

vetëm: një jetë më të mirë për secilin", theksoi Hamza. Duke u zotuar për rritje pagash për 50 për qind, Hamza i kërkoi everisë në detyrë që të mos i shpërdorojë resurset shtetërore me qëllim të krijimit të pabarazisë në garë, në mes subjekteve politike, sepse qytetarëve u duhet mbështetje e përhershme financiare më shumë sesa shtesa të njëhershme. "Do të ketë rritje pagash për 50 për qind dhe kjo do të jetë e përhershme, jo veç ndihmë në kohë të fushatave

zgjedhore, që qytetarët e Kosovës të kenë ndihmë dhe të kenë parashikueshmëri. Kjo nuk i bie që punëtorët e sektorit publik ta marrin një pagë më shumë në vit. Kjo i bie që t'i marrin gjashtë paga më shumë. Dikush që sot e ka pagën 900 euro, i bie që t'i marrë 1350 euro me rritjen e pagës. Ai që e ka 800 i bie me i marrë 1 200. Do të ketë rritje të pensioneve për të gjitha kategoritë", u zotua ai. Lideri i PDK-së u bëri thirrje të gjitha partive politike për një

gjuhë të përmbytur në shërbim të një fushate të qetë, demokratike, korrekte dhe me respekt për standardet e zgjedhjeve të lira. "Mbi të gjitha, Kosova ka nevojë për garë idesh, jo për gjuhë të urrejtjes. Për program dhe përgjegjësi dhe assesi me përçarje dhe përplasje", shtoi Hamza. Ai tha se PDK-ja po hyn në këtë fushatë me respekt për qytetarët, me besim te demokracia dhe me vizion të qartë për ta nxjerrë Kosovën nga kriza.



ka pohuar Elezi.

Me fillimin zyrtar të fushatës zgjedhore, Demokracia në Veprim (DnV) ka paraqitur sot planin dhe komponentët e misionit për vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare të 7 qershorit 2026.

DnV-ja vlerësoi se aktivitetet e parafushatës në terren dhe komunikimi elektoral i subjekteve në hapësirën online kanë filluar tash e një kohë. "Gjithsesi, periudha para nisjes së fushatës zgjedhore është karakterizuar nga vendime qeveritare me ndikim të drejtpërdrejtë në integritetin e procesit zgjedhor dhe barazinë e garës, përmes shpërndarjes së pakove financiare në vlera qindra milionëshe, të orientuara kryesisht drejt kategorive të ndjeshme të popullsisë, përfshirë mërgatën dhe kompanitë private", ka thënë Eugen Cakolli.

Në garën zgjedhore që do të zgjasë 10 ditë, DnV u bëri thirrje subjekteve politike,

kandidatëve dhe të gjithë pjesëmarrësve në proces që t'i respektojnë standardet dhe rregullat në fuqi për një garë demokratike, fer dhe të orientuar në përmbyajtje programore.

Cakolli ka theksuar se DnV-ja do të vlerësojë ecurinë, barazinë dhe kualitetin e fushatës zgjedhore në tre aspekte: Sa shpenzojnë subjektet politike për fushatë në rrjete sociale, përkatësisht platformën Meta (Facebook dhe Instagram), cila është përmbyajtja e sponsorizuar dhe sa i japin hapësirë promovimit të kandidatëve në rrjetet sociale. "Po ashtu, DnV do ta monitorojë gjuhën e urrejtjes, dezinformimin, lajmet e rreme, përmbyajtjet manipuluese dhe trendët kryesorë të komunikimit në rrjetet sociale dhe media online gjatë gjithë periudhës së fushatës. Do të monitorohen edhe mediet tradicionale (televizionet me shtrirje kombëtare) për të vlerësuar nëse mediet

respektojnë standardet për t'u ofruar kohën dhe hapësirën e barabartë të gjitha subjekteve në garë dhe në këtë drejtim rolin që KPM do ta ketë në trajtimin e shkeljeve nga mediet tradicionale dhe të shkruara", ka pohuar ai.

Cakolli ka theksuar se monitoruesit do të përcjellin 11 televizione në gjuhën shqipe dhe serbe për të analizuar sa hapësirë subjektet po u japin kandidatëve të tyre për deputetë dhe kandidatëve për kryeministër. "Vëmendje do t'i kushtohet hapësirë së dedikuar për gratë në zgjedhje, gjuhës dhe temave që do të trajtohen nga subjektet politike. Sa i përket Ditës së Zgjedhjeve, DnV do të angazhojë rreth 500 vëzhgues në nivel vendi, duke përfshirë të gjitha komunat. Vëzhguesit do të vendosen në 500 vendvotimet e përzgjedhura sipas mostrës statistikore të metodologjisë PVT (Parallel

Vote Tabulation). Kjo metodologji do të garantojë vlerësim kredibil dhe të saktë të procesit dhe të rezultateve preliminare. Të dhënat që do të vijnë nga terreni do të shërbejnë që publiku të informohet saktë për rregullsinë e ditës së zgjedhjeve, përfshirë respektimin e procedurave për hapjen dhe mbylljen e vendvotimeve, administrimin e votimit gjatë ditës dhe pjesëmarrjen e votuesve në zgjedhje", është shprehur ai.

Pas ditës së zgjedhjeve, Cakolli ka treguar se DnV-ja përmes vëzhguesve të saj do ta monitorojë procesin e numërimit të votave për kandidatë në të gjitha 38 qendrat komunale të numërimit. "Për këtë operacion do të angazhohen 100 vëzhgues të cilët do ta ndjekin respektimin e procedurave të numërimit, trajtimin e materialit zgjedhor, transparencën e procesit dhe konsistencën e

praktikave ndërmjet komunave të ndryshme. Përveç qendrave komunale të numërimit, DnV do t'i mbulojë edhe zhvillimet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, përfshirë procesin e votave me kusht, votave nga jashtë vendit dhe procedurat eventuale të rinumërimit. Të gjitha observimet nga procesi i vëzhgimit do të publikohen fillimisht përmes deklaratës preliminare dhe më pas raportit përfundimtar, i cili do t'i përfshijë gjetjet dhe rekomandimet për procesin zgjedhor në tërësi. Që nga viti 2007, DnV-ja si rrjet i gjerë i organizatave të shoqërisë civile ka monitoruar të gjitha zgjedhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme, duke e përcjellë nga afër punën e KQZ-së dhe PZAP-it në administrimin e operacioneve, përkatësisht drejtësisë zgjedhore në të gjitha fazat", ka deklaruar Cakolli.

# INSPEKTORATI QENDROR I PUNËS PARAQET SISTEMIN ELEKTRONIK PËR MENAXHIMIN E RASTEVE

Prishtinë, 28 maj - Inspektorati Qendror i Punës, në bashkëpunim të ngushtë me Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO), përmes projektit "Efikasiteti i Inspektoratit të Punës" financuar nga Qeveria e Suedisë, ka paraqitur zyrtarisht Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Rasteve. Ky projekt madhor synon modernizimin e plotë të inspektimeve të punës në Republikën e Kosovës përmes digjitalizimit të proceseve. Kjo konferencë është organizuar me qëllim të prezantimit të rezultateve të fazës pilotuese para institucioneve, partnerëve socialë dhe aktorëve relevantë institucionalë, si hap përmbyllës konsultativ para finalizimit të sistemit dhe hyrjes së tij në fuqi për përdorim zyrtar. Konferenca, po ashtu, synon të sigurojë mbështetje institucionale dhe koordinim ndërinstytucional për zbatimin e suksesshëm të reformës digjitale të

inspektimeve të punës. Risitë dhe përfitimet kryesore të këtij sistemi të ri janë: Inspektime në kohë reale: Sistemi i ri do të mundësojë regjistrimin e inspektimeve direkt nga terreni në kohë reale, duke rritur shpejtësinë dhe saktësinë e të dhënave. Më pak burokraci: Ky proces do të sjellë ulje të ndjeshme të procedurave administrative, duke e bërë punën e inspektorëve më efikase. Transparenca dhe siguri: Rritet transparenca e proceseve dhe siguria në punë për të gjithë punëtorët në Kosovë. Identifikim i shpejtë i shkeljeve: Digjitalizimi do të ndihmojë zyrtarët në identifikimin më të shpejtë të shkeljeve ligjore dhe të sektorëve me rrezikshmëri të lartë. Lehtësi për bizneset: Ndërmarrjet dhe bizneset do të përfitojnë nga procedura shumë më të qarta, si dhe nga një komunikim më i lehtë dhe i



drejtpërdrejtë me institucionet. Ky sistem tashmë është testuar me sukses nga inspektorët në të gjitha rajonet e Kosovës dhe

pritet ta rrisë ndjeshëm efikasitetin dhe llogaridhënien në terren. Inspektorati Qendror i Punës mbetet i përkushtuar në rrugën

drejt modernizimit me qëllim garantimin e të drejtave të punëtorëve dhe krijimin e një mjedisi të drejtë e të sigurt pune.

## GJYKATA E LARTË NË SHQIPËRI VENDOS QË VELIAJ TË MBETET NË PARABURGIM

TIRANË, 28 MAJ - Gjykata e Lartë në Shqipëri vendosi që Erion Veliaj të mbetet në paraburgim. Gjykata nuk e pranoi ankesën e tij, duke e lënë në fuqi vendimin nga shkallët e tjera të gjyqësorisë. Veliaj - që është në mandatin e tretë kryetar i Bashkisë së Tiranës - sipas Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK), dyshohet se ka krijuar skemë korruptive mes disa kompanive në pronësi të bashkëshortes së tij dhe gjashtë biznesmenëve të lidhur me të. Veliaj i ka mohuar të gjitha akuzat. Ai ndodhet në paraburgim që nga 10 shkurti i vitit 2025, në ditën kur u arrestua. Veliaj ka kërkuar në të gjitha shkallët e gjyqësorisë në Shqipëri zëvendësimin e masës "arrest në burg", me masa më të buta



sigurie, si "garanci pasurore" ose "detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore". Pak ditë më parë Gjykata Kushtetuese në Shqipëri vendosi të dërgojë në Gjykatën e Lartë çështjen e masës së sigurisë ndaj Erion Veliajt që të arsyetonte a është

proporcionale masa "arrest me burg" në raport me pozicionin që Veliaj ka si kryebashkiak. Veliaj ka argumentuar se masa e sigurisë i ka cenuar jo vetëm lirinë individuale, por edhe ushtrimin e mandatit si kryetar i zgjedhur i Bashkisë së Tiranës. Ai pretendon se standardet e

një procesi të rregullt ligjor janë shkelur nga të gjitha shkallët e gjykimit, duke argumentuar se është paragjykuar për shkak të statusit dhe pozicionit publik. SPAK-u, në anën tjetër, ka theksuar se ekziston dyshim i arsyeshëm që Veliaj ka kryer vepra penale dhe se rreziku procedural mbetet i lartë, sidomos për shkak të bashkëpunimit të pretenduar me persona të tjerë, ndaj ka kërkuar që ai duhet të qëndrojë në paraburgim. Pas arrestimit Këshilli Bashkiak kishte vendosur për shkarkimin e Veliajt nga detyra. Qeveria shqiptare në atë kohë kërkoi që të mbaheshin zgjedhje në Tiranë për ta zgjedhur kreun e ri të bashkisë, ndërsa presidenti Bajram Begaj dekretoi si datën e zgjedhjeve, 9

nëntorin e vitit 2025. Por, një javë para datës së dekretuar për mbajtjen e zgjedhjeve, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë e rrezoi vendimin e presidentit Begaj dhe të qeverisë shqiptare, duke rikthyer në krye të Bashkisë së Tiranës Veliajn dhe duke anuluar mbajtjen e zgjedhjeve në këtë bashki. Pavarësisht prej vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Veliaj mbeti në paraburgim, pasi Gjykata e Apelit vendosi kundër ndryshimit të masës së sigurisë ndaj tij. Edhe pse ligjërisht Veliaj mbetet kryetar i Bashkisë së Tiranës, në praktikë ky institucion drejtohet nga zëvendëskryetarja Anduela Ristani, që është komanduar në këtë detyrë nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama.

## Kurti: Xhandarmëria do të ketë mandat sigurimin e vijës kufitare tokësore

Prishtinë, 28 maj - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, dhe ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, në një konferencë të përbashkët për medie dhanë informacione lidhur me procesin e themelimit të xhandarmërisë dhe mandatit që ajo parashihet të ketë. Në fjalën hyrëse, kryeministri në detyrë, Kurti, tha se themelimi i xhandarmërisë si strukturë e re e specializuar, moderne dhe e disiplinuar, është domosdoshmëri e

kohës, e cila do ta plotësojë boshllëkun ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Ushtrisë, përkatësisht Forcës së Sigurisë së Kosovës. "Xhandarmëria do të ketë një mandat të qartë: sigurimin e vijës kufitare tokësore, ujore dhe ajrore në tërë territorin e Republikës së Kosovës, operacione kundër grupeve terroriste dhe të armatosura, përfshirë ato me karakter paraushtarak, parandalimi dhe luftimi i të gjitha llojeve të kontrabandës ndërkufitare, si me mallra e me migrantë,

menaxhimi i situatave të rrezikut të lartë si dhe sigurimi i infrastrukturës kritike", tha ai. Kryeministri në detyrë, Kurti, theksoi se modeli i xhandarmërisë ose strukturave të ngjashme është praktikë e dëshmuar evropiane, ndërsa shtoi se modeli i Xhandarmërisë së Kosovës do të ndërtohet në përputhje me sistemin kushtetues, specifikat dhe rrethanat e Republikës së Kosovës. Në Evropë 18 shtete kanë xhandarmëri ose struktura të ngjashme.



## Kosova synon përmbushjen e 111 reformave për të përfituar 882.6 milionë euro nga BE-ja

PRISHTINË, 28 MAJ - U mbajt takimi i radhës i Komiteteve Zbatuese për Agjendën e Reformave në kuadër të mekanizmit të rregullt mujor të koordinimit teknik ndërinstitucional. Ky format mbledh 18 institucionet

përgjegjëse për zbatimin e 111 hapave të reformave deri në fund të vitit 2027, proces përmes të cilit Kosova mund të përfitojë deri në 882.6 milionë euro mbështetje nga Bashkimi Evropian. Takimi u fokusua në gjendjen

aktuale të zbatimit, identifikimin e sfidave dhe përgatitjen e të gjitha veprimeve që mund të zbatohen në këtë fazë. Qëllimi është që të gjitha përgatitjet teknike dhe ndërinstitucionale të kryhen

me kohë, në mënyrë që afatet e Agjendës së Reformave të përmbushen me sukses dhe Kosova të jetë në pozitë të plotë për ta përfituar mbështetjen financiare të paraparë në kuadër të Planit të Rritjes.



## PËRTËRIHET MARRËVESHJA E UP-SË ME ORGANIZATËN "VORAE" PËR MBËSHTETJE TË VAZHDUESHME TË STUDENTËVE ROMË, ASHKALINJ DHE EGJIPTIANË

PRISHTINË, 28 MAJ - Universiteti i Prishtinës përtëriu të enjten marrëveshjen e bashkëpunimit me organizatën joqeveritare "Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve".

Marrëveshja synon krijimin e një kornize të bashkëpunimit mes të dy palëve për mbështetjen e studentëve romë, ashkali e egjiptianë gjatë studimeve universitare.

Me marrëveshje është paraparë që mbështetja e studentëve të tri komuniteteve të bëhet me anë të mekanizmave ekzistues institucionalë, por edhe me krijimin sipas nevojës të mekanizmave të rinj mbështetës.

Marrëveshja u nënshkrua nga rektori i Universitetit të Prishtinës, prof. Arben Hajrullahu dhe menaxheri për edukim në "Zërin e Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve", Orhan Butic.

Rektori Hajrullahu tha se UP-ja po përpqet ta bëjë më të mirën për të ofruar mundësi të barabarta, ndërsa zëvendësrejtori i programit, Butic, tha se fokusi i marrëveshjes duhet të jetë shtimi i inkuadrimin të studentëve të rinj në Universitetin e Prishtinës.

E pranishme në takim dhe gjatë nënshkrimit të marrëveshjes ishte edhe prorektorja për zhvillim institucional, cilësi dhe

çështje studentore, prof. Majlinda Gjellaj dhe zyrtarja e programit të edukimit në "VORAE", Fortesa Shasivari.

Në gusht të vitit 2025 drejtues të Universitetit të Prishtinës qenë takuar me zyrtarë të organizatës "VORAE" dhe deputetin e komunitetit ashkali, Artan Asllani. Përfaqësues të "VORAE"-s kishin ardhur në rektorat edhe kur udhëheqësit e UP-së u takuan me krejtë e organizatave joqeveritare, të specializuara për çështjet e arsimit.

Në Universitetin e Prishtinës 12 për qind të vendeve të lira për studentë në secilin vit akademik janë të rezervuara për komunitetet joshumicë.



## KOMUNAT PO BALLAFAQOHEN ME NDËRHYRJE TË KOMPETENCAVE NË ASPEKTIN JURIDIK E FINANCIAR



PRISHTINË, 28 MAJ - Kolegjiumi i Zyrtarëve Ligjorë të Asociacionit të Komunave të Kosovës, në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Kosovë, mbajti takimin e rregullt të radhës, në të cilin u diskutuan çështje me rëndësi që ndërlidhen me aktet juridike dhe efektet e tyre në nivelin lokal.

Gjatë takimit pjesëmarrësit trajtuan shqetësimet lidhur me aktet juridike të miratuara nga niveli qendror, të cilat po sjellin pasoja të drejtpërdrejta për komunat si në aspektin juridik, po ashtu edhe në atë financiar. Në aspektin juridik u theksua se

disa nga këto akte po ndërhyjnë në kompetencat kushtetuese dhe ligjore të komunave, duke kufizuar autonominë lokale dhe duke krijuar vështirësi në zbatimin e përgjegjësiive komunale.

Po ashtu, në aspektin financiar u diskutua se komunat po përballen me obligime dhe pasoja financiare që burojnë nga vendime apo kontrata për të cilat ato nuk kanë qenë palë në procesin e vendimmarrjes apo nënshkrimit.

Kjo situatë po ndikon negativisht në planifikimin buxhetor dhe funksionimin e

rregullt të komunave.

Pjesëmarrësit vlerësuan nevojën për koordinim më të madh institucional dhe përfshirje të komunave në proceset e hartimit dhe miratimit të akteve juridike që prekin drejtpërdrejt nivelin lokal.

Në përfundim të takimit u dakordua që shqetësimet dhe rekomandimet e ngritura të adresohen tek institucionet përkatëse me qëllim të mbrojtjes së kompetencave komunale dhe garantimit të qëndrueshmërisë financiare të komunave.

## Spanca: Profesionin e auditimit mbetet kyç për transparencë, përgjegjshmëri dhe qeverisje të mirë

PRISHTINË, 28 MAJ - Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, e shoqëruar nga zëvendësauditatori i përgjithshëm Beza Halilaj dhe ndihmësauditatori i përgjithshëm Zukë Zuka, mori pjesë në konferencën "25 vjet në Avancimin e Profesionit: Nga themelet drejt transformimit", organizuar nga Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar të Kosovës (ShKÇAK) me rastin e shënimit të 25-vjetorit të themelimit. Në adresimin e saj ajo vlerësoi

kontributin e ShKÇAK-ut në zhvillimin dhe avancimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë, duke theksuar se ky jubile përfaqëson historinë e konsolidimit të një profesioni me rëndësi të veçantë për funksionimin demokratik dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Ai shtoi se bashkëpunimi me ShKÇAK mbetet partneritet i rëndësishëm profesional dhe institucional, i cili kontribuon në avancimin e kapaciteteve profesionale dhe ngritjen e cilësisë së auditimit në sektorin

publik.

Duke folur për sfidat dhe zhvillimet bashkëkohore në profesionin e auditimit dhe kontabilitetit, Spanca theksoi rëndësinë e integritetit profesional në kohën e transformimit digjital. "Integriteti është themeli dhe kapitali më i madh i profesionit tonë, sepse pa të raportet humbin vlerën, auditimi humb kredibilitetin dhe institucionet humbin besimin e qytetarëve", deklaroi ajo.

Auditorja e Përgjithshme ritheksoi përkushtimin e Zyrës



Kombëtare të Auditimit për promovimin e qeverisjes së mirë, transparencës dhe përdorimit të përgjegjshëm të

parasë publike në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe zhvillimet bashkëkohore profesionale.

## ASK: Çmimet e importit në Kosovë u rritën për 2.7 % gjatë një viti

**PRISHTINË, 28 MAJ** - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIMP) për tremujorin e parë (TM1) 2026.

Indeksi i tërësishëm i çmimeve të importit në Kosovë pati rënie për 0.3 % në TM1 2026 krahasuar me TM4 2025. Ndërkaq, krahasuar me TM1 2025, Indeksi pati rritje prej 2.7 %.

Ngritjet më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve

ishin te: produktet minerale (4,2 %), letra dhe artikujt e saj (4 %), instrumentet optike, fotografike, matëse, mjekësore, muzikore dhe mekanizmat e orës (3 %), pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike 0.9 %, plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (0,7 %) etj.

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorit të shtazët e gjalla; produktet e shtazëve (-2,4 %), tekstili dhe

artikujt e tekstit (-2,1 %), artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit (-2 %), artikujt ushqimorë të përgatitur, pijet dhe duhani (-0,7 %), druri dhe artikujt e tij (-0,2 %) etj.

Çmimet e Importit në Kosovë patën rritje në një mesatare prej 2,7 % ndërmjet (TM1) 2026 dhe (TM1) 2025.

Ngritje më të mëdha sipas sektorëve ishin te: lëkura dhe artikujt e saj (23,2 %), produktet minerale (11,5 %),

instrumentet optike, fotografike, matëse, mjekësore dhe muzikore dhe mekanizmat e orës (7,2 %), artikujt e ndryshëm të prodhuar (7 %), këpucët (5,2%), vajrat ushqyese (5,1 %), shtazët e gjalla; produktet e shtazëve (4,5%), etj.

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorit: produktet bimore (-6,3%), tekstili dhe artikujt e tekstit (-4,5 %), artikujt e gurit, llaçit,



produktet e qeramikës dhe të qelqit (-1,5%), plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (-1,4 %), metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-1,2 %) dhe letrat dhe artikujt e saj (-0,3 %).

## AUTORITETET E KOSOVËS MARRIN NË KONTROLL INFRASTRUKTURËN HEKURUDHORE NË VERI

**PRISHTINË, 28 MAJ** - Autoritetet e Kosovës të enjten në mëngjes morën nën kontroll objektet dhe pronat hekurudhore në Zvečan dhe në Leposaviq, komuna të banuara me shumicë serbe në veri.

Ministri në detyrë i Infrastrukturs, Dimal Basha, ka deklaruar se "nga sot janë kthyer nën menaxhim të plotë të Ndërmarrjes Publike 'Infrakos' të gjitha objektet dhe pronat publike hekurudhore" në veriun e Kosovës.

Ai ka thënë se infrastruktura hekurudhore në veri deri më tani ka qenë "e uzurpuar nga strukturat ilegale paralele serbe". "Ministria e Infrastrukturs dhe Transportit njofton opinionin publik se nga sot janë kthyer nën menaxhim të plotë të Ndërmarrjes Publike 'Infrakos' të gjitha objektet dhe pronat publike hekurudhore në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, të cilat deri më tani ishin të uzurpuara nga strukturat ilegale paralele serbe. Ky aksion është realizuar në koordinim të plotë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Ekonomisë dhe N. P. 'Infrakos'-i dhe përbën një hap të rëndësishëm në forcimin e rendit institucional, shtrirjen e autoritetit shtetëror dhe mbrojtjen e aseteve strategjike të Republikës së Kosovës. Njëkohësisht, ky veprim lehtëson përsheptimin e rehabilitimit, modernizimit dhe funksionalizimit të infrastrukturës hekurudhore në veri të vendit, në përputhje me prioritetet zhvillimore dhe standardet shtetërore të Kosovës", ka thënë Basha.



Basha ka deklaruar, gjithashtu, se hekurudha në veri është një pjesë strategjike e Korridorit X, i cili lidh Kosovën me rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare të transportit.

"Segmenti hekurudhor në veri është pjesë strategjike e Korridorit X, që lidh Kosovën me rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare të transportit, duke rritur potencialin ekonomik dhe integrimin infrastrukturor të vendit. Ministria e Infrastrukturs dhe Transportit, me mbështetjen e Kryeministrit, mbetet e përkushtuar për zbatimin e ligjshmërisë, rikthimin e pronës publike nën kontroll institucional dhe zhvillimin e infrastrukturës moderne në çdo cep të Republikës së Kosovës.

Faleminderit organeve të rendit dhe sigurisë për efikasitetin dhe punën e shkëlqyeshme, kryeshefit Jupaj, si dhe dy kolegëve, ministres Rizvanolli dhe Sveçla për bashkëpunimin!", ka pohuar Basha.

Ndërkaq ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, u ka thënë gazetarëve se ligjet duhet të zbatohen në të gjithë territorin e Kosovës dhe se "Hekurudhat e Serbisë" janë një nga institucionet e fundit "paralele dhe ilegale" që kanë funksionuar.

Kosova gjatë dy viteve të fundit ka mbyllur pothuajse të gjitha institucionet e Serbisë, që pas luftës kanë funksionuar në zonat me shumicë serbe. Derisa

autoritetet e Kosovës thonë se po vendosin rend dhe ligj, pjesëtarët e komunitetit serb këto veprime i shohin si "diskriminim" ose formë "represioni".

Edhe bashkësia ndërkombëtare ka kritikuar mbylljen e institucioneve serbe nga autoritetet e Kosovës, duke theksuar se komuniteteve joshumicë fillimisht duhet t'u sigurohen shërbimet që i kanë marrë përmes sistemit serb.

Ministri Sveçla ka deklaruar se Kosova nuk do ta tolerojë funksionimin e institucioneve serbe dhe se të gjitha do të mbyllën. "Kjo [hekurudha] është pjesë e rrjetit tonë dhe, siç e ka theksuar ministri i Infrastrukturs, do të jetë pjesë

e projekteve për rindërtimin e rrjetit hekurudhor", ka thënë ai. Serbia refuzon t'i mbyllë institucionet e saj në Kosovë, por shumicën prej tyre i ka zhvendosur në qytetet e saj kufitare. Po ashtu, Kosova ngulmon në integrimin e institucioneve arsimore dhe shëndetësore që në zonat ku jeton komuniteti serb funksionojnë sipas sistemit të Serbisë, gjë që po has në kundërshtimin e popullatës lokale, përfaqësuesve politikë dhe shoqërisë civile.

Bashkimi Evropian ka vlerësuar se çështja e integritetit të këtyre dy sektorëve duhet të zgjidhet në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

## Rritet kostoja e ndërtimit

**PRISHTINË, 28 MAJ** - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Kostos së Ndërtimit (IKN) për tremujorin e katërt (TM1) 2026.

Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje për 2,5 % në TM1

2026 krahasuar me TM4 2025. Ndërkaq, krahasuar TM1 2026 me të njëjtën periudhë të vitit paraprak (TM1 2025), Indeksi i Kostos së Ndërtimit pati rritje për 4,3 %.

Indeksi i tërësishëm i Kostos të Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje për 2,5 % në

tremujorin e parë (TM1) 2026 krahasuar me tremujorin e katërt (TM4) 2025.

Rritje kishte transporti 5,9 %, pagat 2,8 %, kostot e tjera 2,6 %, materiale 2,5 % dhe makineritë 0,5 %. Zbritje kishte tek energjia (-3.9 %).

Indeksi i tërësishëm i Kostos të

Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje 4,3 % në tremujorin e parë (TM1) 2026 krahasuar me tremujorin e parë (TM1) 2025. Rritje më të madhe kishte transporti 11,5 %, pagat 8,6 %, kostot e tjera 6,2 %, energjia, 5,5 %, materialet 3,2 % dhe makineritë 0,7 %.



# ZBULOHEK 'THESARI' I BOSIT TË COSA NOSTRAS!



Në agim, ndërsa qyteti i Palermos po zgjohej, Guardia di Finanza e Palermos ishte tashmë në operacion në disa vende të botës.

E koordinuar nga Drejtoria e Antimafias e kryeqytetit sicilian, mega-operacioni çoi në arrestimin e tre personave dhe sekuestrimin e pasurive, kompanive dhe mjeteve financiare me vlerë mbi 200 milionë euro.

Masa, e lëshuar nga gjyqtari për hetimet paraprake i Gjykatës së Palermos, u ekzekutua njëkohësisht jo vetëm në Itali, por edhe në kuadër të një bashkëpunimi gjyqësor dhe policor që përfshiu tetë juridiksione të huaja: Andorrën, Gjibraltarin, Ishujt Kajman, Luksemburgun, Zvicrën, Libanin, Principatën e Monakos dhe Spanjën, me aksione të përqendruara në Malaga, Marbella, Benahavis dhe Puerto Banús, "Marbella e të pasurve" në Costa del Sol, historikisht e frekuentuar nga eksponentë të krimit të organizuar nga e gjithë bota. Nga vitet '80 te parajsat fiskale: trashëgimia ekonomike e bosit

Sipas hetuesve, sistemi financiar tashmë i çmontuar këtë mëngjes i ka rrënjët në vitet '80, kur Cosa Nostra e Trapanit arriti kulmin e fuqisë së saj në tregun ndërkombëtar

të narkotikëve.

Në krye të asaj strukture kriminale qëndronte Matteo Messina Denaro, i njohur si "Diabolik", bosi mafioz nga Castelvetrano, i cili kaloi gati tridhjetë vjet në arrati përpara se të arrestohej më 16 janar 2023 në një klinikë në Palermo, ku po kryente kimioterapi nën identitet të rremë.

Ai vdiq më 25 shtator 2023 në burgun e L'Aquillas.

Sipas Guardia di Finanza, operacioni përfaqëson kulmin e një hetimi të gjatë dhe kompleks që bëri të mundur rindërtimin e një pasurie të madhe, fryt i riinvestimit të kapitaleve të krijuara nga trafiku i drogës, të cilat me kalimin e kohës kishin kaluar përmes një rrjeti të dendur kompanish "offshore" për t'u rifutur më pas në ekonominë ligjore në vende të ndryshme. Nuk bëhet fjalë për një kasafortë përplot me para, por një sistem financiar të sofistikuar dhe të shtrirë në nivel global, përshtypje e paralajmëruar tashmë nga një investigim i "Repubblica" më 21 maj.

Hetimet i vendosin kapitalet që i atribuohen rrjetit të Messina Denaros mes Veronës dhe Londrës, duke kaluar përmes Dublinit, Qipros dhe Maltës, me një rrjet transaksionesh të ndërtuar me kalimin e kohës

përmes përdorimit të personave të padukshëm si mbulesë.

Ndër sektorët e investimeve nën hetim, një nga nyjet kryesore rezultoi sektori i energjive të rinovueshme, veçanërisht energjia e erës në Sicili, e konsideruar nga hetuesit si një nga portat kryesore të hyrjes së sistemit ekonomik të bosit.

## Pasuritë e konfiskuara dhe rrjeti i personave që shërbenin për kamuflim

Historia e pasurive të lidhura me emrin e Messina Denaros ka prodhuar tashmë sekuestrime kolosale ndër vite. Në vitin 2013, Gjykata e Trapanit urdhëroi konfiskimin e kompanive, tokave dhe pasurive të paluajtshme që i atribuoheshin sipërmarrësit Giuseppe Grigoli, i konsideruar nga hetuesit si një nga personat kryesorë mbulesë të bosit, me vlerë 700 milionë euro.

Që në vitin 2008, rreth Grigolit ishin sekuestruar pasuri me vlerë 700 milionë euro si kompani, prona dhe toka; më pas konfiskimi u konfirmua. Së fundmi, financierët e komandës provinciale të Palermos kishin sekuestruar, në mars 2025, pasuri me vlerë

mbi 3 milionë euro të Giovanni Luppinos, shoferit të bosit të arrestuar bashkë me të përpara klinikës "La Maddalena" në janar 2023 dhe më pas të dënuar me mbi nëntë vite burg.

Sipas hetuesve, Luppino nuk ishte kufizuar vetëm në mbështetje logjistike për bosin, por kishte luajtur një rol aktiv në financimin e arratisë së tij, përmes transfertave bankare dhe çeqeve të lidhura me persona pranë Messina Denaros.

Operacioni futet në një kuadër hetimor që vetë prokuroritë antimafia po e përshkruajnë me shqetësim në rritje. Vetëm pesë ditë më parë, më 23 maj 2026, Prokurori Kombëtar Antimafia dhe Antiterrorizëm Giovanni Melillo foli në Palermo, në kuadër të aktivitetit dyditor mbi bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar të përfshirë në programin european EL PAÇTO 2.0, duke paralajmëruar se konfliktet e armatosura u ofrojnë rrjeteve kriminale kushte ideale për të lëvizur mallra, para dhe marrëdhënie institucionale të leverdishme. Në qendër të alarmit ishin trekëndëshat e ndërtuar për të shmangur tarifën doganore, sanksionet dhe embargot, me një presion gjithnjë e më të madh mbi sistemet kombëtare


të hetimit, pasi mafiet operojnë në rrugë globale ndërsa provat penale mbeten të lidhura me rregulla territoriale.

Mes qendrave financiare të përfshira në sekuestrime spikasira destinacione që në hartën e pastrimit ndërkombëtar të parave përsëriten me një rregullsi tragjike.

Ishujt Kajman, në arkipelagun karaibik, përfaqësojnë prej dekadash një nga strehët kryesore financiare për kapitalet me origjinë të paligjshme.

Andorra dhe Gjibraltari, mikro-shtete me regjime fiskale të favorshme, shërbejnë si nje ndërmjetëse. Luksemburgu dhe Zvicra, me sistemet e tyre bankare ndër më të rezervuarat në Europë, plotësojnë panoramën europiane. Libani dhe Principata e Monakos e zgjerojnë edhe më tej perimetrin gjeografik të hetimit.

Spanja jugore, në fund, me zonat e Costa del Sol, Malaga, Marbella, Benahavis dhe Puerto Banús konsiderohen historikisht si disa nga destinacionet e preferuara të krimit të organizuar european për të investuar të ardhurat e aktiviteve të paligjshme në pasuri të paluajtshme dhe luks./IlGiornale



## Crystal Palace shkruan histori, fiton Konferencë Ligën

LEIPZIG, 28 MAJ - Crystal Palace është shpallur kampion i Konferencë Ligës pasi ka mposhtur me rezultat minimal 1-0 skuadrën spanjolle Rayo

Vallecano në finalen e zhvilluar në "Red Bull Arena" të Lajpcigut. Hero i londinezëve ishte Jean-Philippe Mateta, i cili ka realizuar golin vendimtar në

minutën e 51-të, duke nderur festën e madhe të tifozëve anglezë. Finalja ishte tepër e luftuar, me shumë duela dhe kartonë të verdhë, por skuadra angleze

arriti ta ruajë epërsinë deri në fund. Për Crystal Palace ky është një moment historik, pasi klubi anglez ka fituar trofeun më të madh evropian në historinë e tij.



## FODA: MIQËSORJA NDAJ ÇEKISË DHE ANDORRËS NA SHËRBEJNË PËR LIGËN E KOMBEVE

PRISHTINË, 28 MAJ - Përzgjedhësi i Kombëtares së Kosovës, Franco Foda, është paraqitur në konferencë për medie në ditën e parë të grumbullimit të "Dardanëve" për dy ndeshjet miqësore ndaj Republikës së Çekisë dhe Andorrës.

Kosova do ta zhvillojë ndeshjen e parë miqësore më 31 maj në udhëtim kundër Çekisë, ndërsa më 7 qershor do ta presë Andorrën në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Duke folur për gjendjen e ekipit pas humbjes në finalen e "play-off"-it të Botërorit 2026 ndaj Turqisë, Foda ka theksuar se ajo nuk ka qenë e lehtë për grupin, por shtoi se Kombëtarja duhet të shikojë përpara dhe ta vazhdojë procesin e zhvillimit. "Sigurisht se nuk ka qenë e lehtë pas humbjes nga Turqia. Duhet të vazhdojmë tutje, të shikojmë përpara dhe të punojmë së bashku. Duhet të zhvillohemi edhe më shumë si ekip", ka thënë Foda.

Përzgjedhësi gjerman ka thënë

se dy miqësoret e radhës do të shërbejnë si përgatitje e rëndësishme për ndeshjet e ardhshme zyrtare në Ligën e Kombeve. "Ndeshjet e radhës do t'i shfrytëzojmë për t'u përgatitur për sfidat që na presin në Ligën e Kombeve. Qëllimi afatshkurtër është qëndrimi në Ligën B, kurse ai afatgjatë është të vazhdojmë zhvillimin të ngjitemi në Ligën A. Gjithsesi, objektivi ynë i madh mbetet kualifikimi në Euro 2028", ka thënë ai.

Foda ka folur edhe për mungesën e Vedat Muriqit dhe të ardhmen e tij te Kombëtarja, duke bërë me dije se sulmuesi ka vendosur të pushojë pas një sezoni të gjatë me Mallorcan. "Kam pasur kontakt me Vedat Muriqin. Ai ka pasur një sezon të gjatë dhe ka luajtur shumë ndeshje. Pas pushimit veror, në shtator, Vedati do të rikthehet te Kombëtarja dhe do ta mbështesë ekipin", ka thënë Foda.

Përveç Muriqit, në këtë grumbullim do të mungojnë



edhe Milot Rashica, Florent Hadërgjonaj dhe Fidan Aliti për shkak të lëndimeve. Foda ka theksuar se ka biseduar me të tre lojtarët dhe se ata mbeten të përkushtuar ndaj Kombëtares. "Me të tre lojtarët kam biseduar. Janë të lënduar dhe nuk kanë shprehur dëshirë për t'u larguar. Përkundrazi, duan të vazhdojnë me Kombëtaren e Kosovës", ka thënë përzgjedhësi Foda.

Ai është ndalur edhe te prurjet e reja Dardan Shabanhaxhaj, Rilind Nivokazi dhe Valmir Matoshi, duke thënë se paraqitjet e tyre kanë lënë përshtypje të mirë. "Të tre lojtarët i kam vëzhguar në

ndeshjet e tyre. Kam qenë në Lugano kur kanë luajtur ndaj Sionit dhe më kanë dhënë përshtypje të mirë. Nëse vazhdojnë me paraqitje të mira, do të kenë mundësi të jenë pjesë e Kombëtares edhe në të ardhmen", ka thënë Foda. Përzgjedhësi i Kosovës ka konfirmuar se po ndjek nga afër edhe futbollistët e Superligës së Kosovës. Ai ka veçuar Rin Ahmetin e Prishtinës si një lojtar me potencial, por ka theksuar se ai duhet ta vazhdojë zhvillimin e tij gradualisht. "Sigurisht se i përcjell edhe ndeshjet e ligës së Kosovës. Disa lojtarë më kanë rënë në sy. Disa prej tyre janë ftuar te Kombëtarja U21. Jam në kontakt të vazhdueshëm me përzgjedhësin e kombëtares U21 dhe ai më informon për zhvillimin e tyre. Rin Ahmeti i Prishtinës është lojtar interesant, por ai duhet të vazhdojë tutje dhe të mos ndalet", ka thënë Foda.

Në konferencë është folur edhe për të ardhmen e Valon

Berishës te Kombëtarja. Foda ka vlerësuar kontributin e mesfushorit ndër vite dhe tha se në javët e muajt në vijim do të zhvillohen bisedime për hapat e ardhshëm. "Valoni ka kontribuar shumë për Kosovën. Do të flasim në javët dhe muajt në vazhdim se si do të rrjedhë e ardhmja e tij te Kosova", ka thënë Foda.

Ndërsa menaxheri i Kombëtares, Bajram Shala, ka bërë me dije se Amir Saipi do t'i bashkohet ekipit më 1 qershor për arsye personale, sikurse edhe Bersant Celina, që për shkak të angazhimeve me klubin e tij, AIK do të mungojë në ndeshjen e parë.

Pas dy ndeshjeve miqësore, Kosova do ta nisë rrugëtimin në Ligën e Kombeve në shtator, ku garon në Grupin 3 të Ligës B së bashku me Austrinë, Izraelin dhe Irlandën. Ndeshjen e parë, "Dardanët" do ta zhvillojnë më 24 shtator në Prishtinë kundër Irlandës, ndërsa më 27 shtator do të luajnë në Vjenë ndaj Austrisë.

## MEDIUMI TURK: MURIQI TE FENERBAHÇE, PUNË E KRYER

STAMBOLL, 28 MAJ - Ish-presidenti i Fenerbahçes, njëherësh kandidat për ta rimarrë drejtimin e klubit turk, Aziz Yildirim, ka arritur marrëveshje me sulmuesin e kombëtares së Kosovës dhe të Mallorcas, Vedat Muriqi. Sipas asaj që po raporton "HT Spor", Yildirim ka arritur një marrëveshje me ish-sulmuesin e skuadrës turke dhe theksohet se sulmuesi i Kosovës do ta nënshkruajë kontratën vetëm nëse Yildirim rizgjedhet president në asamblenë e përgjithshme. Ish-ylli i Fenerbahçes është ringritur gjatë qëndrimit të tij në Spanjë. 32-vjeçari ka shënuar 23 gola dhe ka bërë një asist këtë sezon në 37 ndeshje zyrtare për Mallorcan. Me gjithë golat e tij të shumta, Mallorca nuk ka arritur të qëndrojë në superligën spanjolle këtë sezon.



## UZUNI MUND TË RIKTHEHET NË FUTBOLLIN EVROPIAN

TRABZON, 28 MAJ - Skuadra turke, Trabzonspor, dëshiron ta transferojë sulmuesin e Shqipërisë, Myrto Uzunin. "Habergo" ka shkruar se Trabzoni është duke e monitoruar nga afër situatën e Uzunit. Uzuni luan për skuadrën nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Austin. Paraqitjet pozitive të Uzunit me Austinin këtë edicion kanë bërë që Trabzoni të shprehë interesim. 30-vjeçari me Austinin ka kontratë deri në fund të vitit të ardhshëm. Trabzoni kishte bërë përpjekje të nënshkruante me Uzunin edhe në afatin kalimtar të janarit, por transferimi nuk u realizua. Uzuni tek Austini ishte transferuar vitin e kaluar nga Granada spanjolle për 12 milionë euro.



## Viniciusi: Dua të qëndroj gjithë jetën te Reali

MADRID, 28 MAJ - Ylli brazilian Vinicius Junior ka shprehur dëshirën për t'u pensionuar te Real Madridi pavarësisht prej spekulimeve të muajve të

fundit. Sidoqoftë, ai kë thënë se nuk e ka me nxitim ta rinovojë kontratën me madrilenët. "Dua të qëndroj te Real Madridi për gjithë jetën time,

gjithashtu nuk jam me nxitim për ta rinovuar kontratën. Kam kontratë deri në vitin 2027. Ky është klubi i ëndrrave të mia. Nuk e kam imagjinuar kurrë

veten larg Real Madridit. Presidenti ka besim tek unë dhe unë kam besim tek ai. Tani jam një nga kapitenët", ka thënë Viniciusi.







Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**  
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

U shtetë të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit Kombëtare (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 05/2026), lidhur me nenin 49 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 03/2025), Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2026 si dhe Vendimit të Auditorit të Përgjithshëm me Nr.831 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit ri shpall:

### KONKURS za popunjavanje slobodnog radnog mesta

<b>1. Pozicija:</b>	<b>Službenik za registraciju i čuvanje arhivskog materijala</b>
<b>Broj reference:</b>	RZRMA/ZKA/07-04/26
<b>Rang:</b>	ZKA-X6
<b>Broj pozicija:</b>	Jedna (1)
<b>Trajanje imenovanja:</b>	Na neodređeno vreme

#### Dužnosti i odgovornosti:

- Primena zakona i standarda u vezi sa registracijom i čuvanjem arhivskog materijala;
- Klasifikacija i sistematizacija arhivskih dokumenata, uključujući njihov opis, numerisanje i katalogizaciju, u skladu sa arhivskim pravilnicima i procedurama;
- Obezbeđivanje adekvatnog čuvanja arhivskog materijala kako bi se izbegla fizička oštećenja ili gubitak;
- Evidentiranje dokumenata i arhivskog materijala u elektronskim bazama podataka;
- Efikasno pronalaženje dokumenata za ovlašćena lica ili zainteresovane strane za arhivski materijal;
- Priprema i organizacija materijala predviđenih za interno ili eksterno slanje;
- Izrada izveštaja ili materijala prema internim ili eksternim zahtevima;
- Poštovanje rokova za uništavanje ili prenos dokumenata;
- Priprema materijala za predaju ili transfer u državne arhive;
- Podrška u procesu digitalizacije arhivskog materijala radi lakšeg pristupa i dugoročnog čuvanja;
- Saradnja sa drugim odeljenjima u cilju koordinacije i unapređenja procesa upravljanja dokumentima, uključujući njihovo arhiviranje.

#### Opšte formalne kvalifikacije za ovu poziciju su:

- Obrazovanje: Univerzitetska diploma iz oblasti društvenih nauka;
- Radno iskustvo: Tri (3) godine radnog iskustva u administraciji

#### Potrebne veštine:

- Veštine komunikacije i planiranja rada;
- Poznavanje rada na računaru za administraciju i arhiviranje materijala (npr. Microsoft Office);
- Dobro poznavanje zakona i propisa u vezi sa arhivama i dokumentima;
- Sposobnost za samostalan i timski rad;
- Dobre interpersonalne veštine.

#### Opšte informacije za kandidate:

Utvrđivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonodavstvom.

#### Procedura prijavlivanja:

Procedura prijavlivanja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju uslove konkursa. Nacionalna kancelarija revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i ohrabruje prijavu kandidata iz svih zajednica na Kosovu.

#### Kandidati treba da dostave sledeću dokumentaciju:

- zvanični obrazac NKR-a za prijavu;
- kopiju lične karte Republike Kosovo;
- dokaze o stručnoj spremi (univerzitetska diploma). Diplome stečene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- dokaze o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili potvrda o radnom odnosu, uz prateće dokaze iz Trusta);
- potvrdu suda da kandidat nije osuđivan pravosnažnom presudom (ne stariju od šest meseci);
- potvrdu da nema važeću disciplinsku meru razrešenja sa pozicije javnog službenika (*ukoliko je primenljivo*);

U razmatranje će biti uzet samo zvanični formular za konkurisanje. Dokumentacija dostavljena nakon isteka roka neće biti razmatrana, dok će nepotpuna dokumentacija biti odbijena. Kontaktirajte se samo kandidati koji ispunjavaju uslove. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (online) i na internet stranici Nacionalne kancelarije revizije. Krajnji rok za podnošenje dokumentacije je datum **13.06.2026 u 16:00 casova**.

Formulari za prijavu mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili sa internet stranice [www.zka-rks.org/](http://www.zka-rks.org/), a dostavljaju se u Diviziju za upravljanje dokumentima na adresu: Naselje Arbëria, ul. „Ahmet Krasniqi“ br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Formular i prateća dokumentacija mogu se dostaviti i putem elektronske pošte na adresu [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org) ili putem pošte. Za dodatne informacije možete kontaktirati na broj telefona: 038/606-004, lok. 1025.

#### Beleška:

Prijave poslate putem pošte koje nose poštanski pečat sa datumom poslednjeg dana roka za prijavu smatraće se važećim i biće uzete u razmatranje.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**  
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit Kombëtare (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 05/2026), lidhur me nenin 49 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 03/2025), Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2026 si dhe Vendimit të Auditorit të Përgjithshëm me Nr.831 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit ri shpall:

### KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

<b>1. Pozita:</b>	<b>Zyrtar për regjistrim dhe ruajtje të materialit arkivor</b>
<b>Numri i referencës:</b>	RZRMA/ZKA/07-04/26
<b>Grada:</b>	ZKA-X6
<b>Numri i pozitave:</b>	Një (1)
<b>Kohëzgjatja e emërimit:</b>	Me kohë të pacaktuar

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zbatimi i ligjeve dhe standardeve në lidhje me regjistrim dhe ruajtje të materialit arkivor;
- Klasifikimi dhe sistematizimi i dokumenteve arkivore, duke përfshirë përshkrimin, numërimin dhe katalogimin e tyre sipas rregulloreve dhe procedurave arkivore;
- Sigurimi i ruajtjes së duhur të materialit arkivor për të shmangur dëmtimin fizik apo humbjen;
- Regjistrimi i dokumenteve dhe materialeve arkivore në bazat e të dhënave elektronike;
- Rigjetje optimale të dokumenteve për personat e autorizuar ose palët e interesuara për materialin arkivor;
- Përgatitja dhe organizimi i materialeve të përcaktuara për dërgim të jashtëm apo të brendshëm;
- Përgatitja e raporteve ose materialeve sipas kërkesave të brendshme ose të jashtme; Respektimi i afateve kohore për asgjësimin ose transferimin e dokumenteve;
- Përgatitja e materialeve për dorëzim ose transferim në arkivat shtetërore;
- Mbështetja në procesin e digjitalizimit të dokumenteve arkivore për të siguruar qasje më të lehtë dhe ruajtje afatgjatë;
- Bashkëpunimi me departamentet e tjera për koordinimin dhe përmirësimin e proceseve të administrimit të dokumenteve, përfshirë arkivimin e tyre.

#### Kualifikimet e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

- Arsimitimi: Diplomë fakulteti në shkencat shoqërore;
- Përvojë profesionale: Tre (3) vite përvojë pune në administratë.

#### Shkathësitë e kërkuara:

- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Përdorimi i programeve kompjuterike për administrim dhe arkivim të materialeve (p.sh., Microsoft Office);
- Njohuri të mira për ligjet dhe rregulloret në lidhje me arkivat dhe dokumentet
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe ekipore;
- Të posedojë aftësi të mira ndër-personale.

#### Informata të përgjithshme për kandidatët:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

#### Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuar;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (*nëse aplikohet*);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (*online*) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **13.06.2026, ora: 16:00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën [www.zka-rks.org](http://www.zka-rks.org) dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org) ose përmes postës. Për informata më të hollëshme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

#### Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.

**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992





ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

**ANNOUNCING THE 2017  
QUALITY & SALES AWARDS**

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1905

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1905  
0.5L